

Nr. 733 / Prot.

Lenda: Dergohen ndryshimet ne aktet e themelimit te shoqerise.

SHOQERISE "POSTA SHQIPTARE" S.H.A.

TIRANE

Me cilesine e aksonerit te vetem te shoqerise "Posta Shqiptare" sh.a. Tirane, peraktuar ne Ligjin nr. 8885, date 22.04.2002 "Per ne ndryshim ne Ligjin nr. 7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjes shetoreore ne shoqeri tregtare", si dhe me propozimin e Sh.a. "Posta Shqiptare" Tirane, Ministri i Ekonomise ka nxjerre Urdherin nr. 54, date 02.03.2005 "Per ndryshim ne aktet e themelimit te shoqerise "Posta Shqiptare" sh.a. Tirane".

Ne zbatim te nenit 33, te ligjit nr. 7667, date 28.01.1993 "Per Rregjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen kryer nga shoqerite tregtare", Shoqeria te marre masa per depozitim e ndryshimeve ne aktet e themelimit te shoqerise ne Rregjistrin Tregtar.

Bashkelidhur eshte Urdheri nr. 54, date 02.03.2005, i Ministrit te Ekonomise "Per ndryshime ne aktet e themelimit te shoqerise "Posta Shqiptare" sh.a. Tirane".

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TE PRONE PUBLIKE
KOCOLLARI
REJTOR

STATUTI

SHOQERISE "POSTA SHQIPTARE" sh.a.

URDHER

Nr. 54 date 2.3.2005

PER NDRYSHIME NE AKTET E THEMELIMIT TE SHOQERISE "POSTA SHQIPTARE" S.H.A. TIRANE

Duke marre parasysh Statutin e shoqerise anonime "Posta shqiptare" sh.a. Tirane,

KONSTATOVA:

Se ne baze te nenit 1 te Ligjit nr. 8885, date 22.04.2002, "Per ne ndryshim ne Ligjin nr. 7926 dt. 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjes shetoreore ne shoqeri tregtare", si dhe VKM nr. 271 dt. 09.05.1998 "Per miratimin e Statutit Tip te shoqerive anonime shetoreore", duhet te behen disa ndryshime ne aktet e themelimit te "Alba-Post" sh.a. Tirane.

Per sa me siper ne mbeshetje te nenit 102 pika 4, te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise.

URDHEROJ:

I. Ndryshimi i Statutit te "Alba-Post" sh.a. Tirane si me poshte:

Neni 1 formulohet:

Forma dhe emertimi i shoqerise

- Shoqeria anonime e krijuar ne baze te legjislacionit te Republikes se Shqiperise nga transformimi i Ndermarrjes se Postes Shqiptare emerohet sh.a. "Posta Shqiptare", Tirane.
- Sh.a. "Posta Shqiptare", eshte organizuar dhe funksionon ne perputhje me dispozitat e ketij statuti.
- Shoqeria ka stemen dhe vlen e saj e cila miratohet nga Keshilli Mbiqyres i Shoqerise.

Neni 2 shohet:

Selia

- Selia e shoqerise eshte: "Ruga Reshit Collaku" Nr.4, Tirane.
- Asambleja e akcioneve mund te ndryshoje seline e shoqerise, mund te hap veprimtari ose nje te reja dhe te ndryshoje objektin e shoqerise.

- Lidhur me marrëdhëniet ndërmjet shoqërisë dhe akcioneve, vendndodhja e çdo akcioni është ajo e përcaktuar në regjistrin e akcioneve.

Neni 3

Kohezgjatja

- Kohezgjatja e shoqerise eshte e pakufizuar.

Neni 4

Objekti i shoqerise

- Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte:
- Aktiviteti i gjetitje shërbimeve postare te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi per postat ne territorin e Republikes se Shqiperise.
 - Aktiviteti i shërbimeve financiare dhe bankare ne perputhje me legjislacionin bankar dhe licencen e shërbimeve financiare Banka e Shqiperise.
 - Shoqeria siguron ofrimin e shërbimeve postare dhe financiare ne te gjithë territorin e Republikes se Shqiperise.

1. Shërbimet postare përfshijnë:

- Korrespondencën, letrat, kartpostalat, shtypshkrimet, mostrat, literaturën për të verërit, paketat e vogla, kolportesh, telefaksin, urdherpagesat.

2. Aktiviteti postar mbulon fushat e mëposhteme:

- Prodhimin, emetimin, vlerën në qarkullim dhe tërheqjen nga qarkullimi të pullave postare dhe objekteve të lidhura me to, pranimin, përputhjen, veprimin dhe shpërndarjen e objekteve postare.

2. Aktiviteti i shërbimeve financiare përfshijnë:

- Shërbimet financiare dhe bankare, aktivitetet e sigurimit, shërbime transporti dhe shpërndarjes së librave dhe gazetave, bashkëpunimin në shërbime transporti dhe tërheqjen e pasurive të operatorëve që ofrojnë këto shërbime, bashkëpunimin në shërbimin publik, nëpërmjet kabineve telefonike publike me operatorë që ofrojnë këto shërbime, shërbimet ndërmjetse të lidhura me qarkullimin e parave, kryerjen e veprimjeve bankare për llogari të të tjerëve, transferat parash e shërbime të tjera.

Shoqeria brenda çfaqet te parashtruar nga legjislacioni ne fuqi, do te kryej çdo operacion tregtar dhe financiar qe lidhet drejtpërdrejt ose terthorazi me objektin e saj. Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive dhe veprimtarive të shoqerise te reja si dhe pjesëmarrjen ne kapitalin e shoqerive te tjera brenda dhe jashte vendit.

Neni 5

Kapitali i Shoqerise

- Kapitali i Shoqerise eshte 697.542.000 leke.
- Nga kjo, vlera e turrallit 22.853.003 leke. Numri i aksioneve eshte 697.542.
- Vlera nominale e aksioneve 1000 leke.
- Promari i vetem i aksioneve eshte shteti Shqiptar i perfaqesuar nga Ministri e Ekonomise.

- Ndryshimi i kapitalit dhe transferimi i aksioneve

- Ndryshimi i kapitalit te shoqerise dhe transferimi i aksioneve ne rastin e privatizimit, mund te behet vetem me vendim te Asamblesë se Jashtzakonisht te Aksioneve, ne baze te raportit te Drejtorise se Shoqerise te hartuar ne perputhje me dispozitat e ligjit nr. 7638 dt. 19.11.1992 "Per shoqerit tregtare".
- Sa koke qe aksoneri i vetem i shoqerise eshte shteti shqiptar i perfaqesuar nga Ministri i Ekonomise, veprimet e mesiperme do te kryhen vetem me Urdher te Tij.

Neni 7

Organet drejtuese te shoqerise

- Organet drejtuese te shoqerise jane:

- Keshilli Mbiqyres.
- Drejtoria.

Neni 8

Perberja dhe emerimi i anetareve te keshillit mbiqyres

- Keshilli Mbiqyres perbehet nga 6 (gjashte) anetare. Anetaret e Keshillit Mbiqyres emerohen nga Ministri i Ekonomise ne perputhje me kriteret e përcaktuara ne akte nenligjore.
- Kohezgjatja e funksionit te anetarit te keshillit mbiqyres eshte 4 (kater) vjet. Anetaret e keshillit mbiqyres jane te azagjitshem dhe mund te shpallin funksionin e tyre. Me kete keshill mbiqyres mund te shpallin funksionin e tyre gjate te perijudes se mandatit katervjeçar. Ne rast lirim, i rizzgjedhuri ploteson mandatin e paraardhesit.
- Anetaret e Keshillit Mbiqyres jane persona fizik. Ata nuk mund te jene te punesuar ne shoqeri.
- Anetaret e Keshillit Mbiqyres nuk mund te bejne pjese ne me shume se tre (3) Keshilla Mbiqyres te shoqerive qe e kane seline ne Republiken e Shqiperise.

- Ne rast vdekje, lirim nga detyra, apo dorëheqje, vendi vakant duhet te zëvendësohet jo me vone se 3 (tre) muaj. Antari i emruar se te zëvendësuar nje antar te Keshillit Mbiqyres, ploteson kohen e mbetur te mandatit katervjeçar te paraardhesit.
- Anetaret e Keshillit Mbiqyres te moshes mbi 65-vjeç nuk mund te jene me shume se 1/3 e numrit te përgjithshem te anetareve te Keshillit Mbiqyres. Nese ky raport tejkalohet, anetari me i vjeter zyrtarisht eshte i liruar nga detyra.

Neni 9

Kryetari dhe zëvendës kryetari i Keshillit Mbiqyres

- Kryetari Mbiqyres, zgjidhet ndërmjet anetareve te tij nje kryetar dhe nje zëvendës kryetar. Kryetari i keshillit mbiqyres (ne mungese te tij, zëvendës kryetari), thërret mbledhjet e Keshillit Mbiqyres dhe drejton diskutimet.
- Kryetari dhe zëvendës kryetari i keshillit mbiqyres jane persona fizik. Ata ushrojne funksionet e tyre gjate tre perijudes se mandatit katervjeçar. Ne rast lirim, i rizzgjedhuri ploteson mandatin e paraardhesit.
- Keshilli Mbiqyres mund te ngarkoje nje person si sekretar, qofte dhe jashte radhëve te tij.

Neni 10

Mbledhjet dhe vendimet e Keshillit Mbiqyres

- Keshilli Mbiqyres mbledhet rregullisht te pakten njehere ne tre muaj (ne funde te çdo tre mujor) dhe sa here qe e kerkon interesi i shoqerise me thirrjen e kryetarit ose ne mungese te tij, te zëvendës kryetari.
- Kryetari thërret Keshillin Mbiqyres, brenda 15-ditesh nga kërkesa e motivuar e Drejtorise se Shoqerise, ose e 1/3 e anetareve te Keshillit Mbiqyres. Nese kërkesa mbetet pa pergjigje, atehere kerkuesit mund te therrasin mbledhjen e Keshillit Mbiqyres duke peraktuar rendin e dites.
- Thirrja behet 3 (tre) dite perpara mbledhjes, me ane te nje letre, telegrami, teletaks apo faksi. Thirrja mund te jete e vlefshme edhe kur eshte gojore dhe pa ndone afat te caktuar kohor, nese anetaret e keshillit mbiqyres duhe te pranojne ate.
- Çdo thirrje permban rendin e dites, datën, orën dhe vendin e zhvillimit te mbledhjes. Mbledhjet e Keshillit Mbiqyres zhvillohen zakonisht ne seline e shoqerise ose ne çdo vend tjeter qe tregohet ne thirrje.
- Rendi i dites se mbledhjes caktohet nga kryetari i keshillit mbiqyres ne baze te programit vijtor te aktivitetit te keshillit mbiqyres, te miratur ne fillim te vitit. Keshilli mbiqyres mund te kerkon ndryshime te reja dhe ndryshime te keshillit mbiqyres gjate vitit nga anetaret e keshillit mbiqyres ose nga drejtoria.
- Per çdo mbledhje te Keshillit Mbiqyres, ne nje rregjister te veçante, mbahet procesverbali i cili nënshkruhet nga te gjithë anetaret e pranishem ne mbledhje. Ne te pasqyrohen:
 - data dhe vendi i mbledhjes,
 - menyra e thirrjes, pjesëmarrësit,
 - rendi i dites, drejtuesin e mbledhjes,
 - permblledhjet e diskutimeve dhe raportet qe do te diskutohen,
 - permblledhjet te diskutimeve te pjesëmarrësve,
 - rezultatit i votimit dhe vendimet qe merren.

- Vendimet qe merren ne mbledhjen e keshillit mbiqyres ne pajtim me dispozitat ligjore dhe fuqi te evidencuara sipas proces-verbalit, nënshkruhen nga kryetari (ose zëvendës kryetari) dhe sekretari.
- Keshilli Mbiqyres mund te marre vendime te vlefshme nese jane te pranishem jo me pak se gjysma e anetareve te tij (vetem ne lirimin dhe kete anetare te drejtorise duhet votat e 2/3 te anetareve te keshillit mbiqyres). Vendimet merren me shumice te thjeshte votash te anetareve te pranishem. Ne rast votash te barabarta, vota e kryetarit eshte përcaktuese.
- Keshilli Mbiqyres, nese e shet te arsyeshme, mund te therras ne mbledhjen e tij Drejtorine, ekspertet kontabel te miratuorose pale te trita per qellime keshillimi.

Neni 11

Kompetencat e Keshillit Mbiqyres

- Keshilli Mbiqyres ushtron kontroll te vazhdueshem ndaj drejtorise per administrimin e shoqerise nga ana e saj. Ai i jep kesaj te fundit autorizimin per te kryerje operatione qe nuk mund te kryen nga Drejtoria pa autorizimin e Keshillit Mbiqyres.
- Keshilli Mbiqyres ka te drejte te verifikojte dhe kontrolloje ne çdo koke dokumentacionin qe e gjykon te nevojshem per përmeshjen e te gjithë detyrave te tij.
- Keshilli Mbiqyres percakton numrin e anetareve te drejtorise dhe emerion anetaret e saj kur jane dakord jo me pak se 2/3 e te gjithë anetareve te keshillit mbiqyres. Me miratimin paraprak te Ministrir te Ekonomise (Asamblese), Keshilli Mbiqyres ngarkon njerin prej anetareve te drejtorise me cilesine e drejtorit te pergjithshem te shoqerise.
- Keshilli Mbiqyres mund te sharkoje secilin prej tyre per shakaqe te perligjura ose kur asambleja humbet besimin tek ai.
- Me emerimin e anetareve te drejtorise, Keshilli Mbiqyres lidh kontrate me ta per detyrimet qe rrjedhin per administrimin e shoqerise.
- Keshilli Mbiqyres percakton nivelin e njese se auditimit te brendshem ne shoqeri si strukturat me vete. Emerion kryetarin e njese me procedura te njehet me ato te anetareve te drejtorise.
- Miraton programin vijtor te zhvillimit ekonomik-financiar dhe te auditimit te brendshem dhe analizon e kontrollon zbatimin tremujor te tyre. Ne çdo tre mujor, me menyre te permblledhur, informon Ministrine e Ekonomise dhe ministrine e linjes administrative, ne drejtorite perkatese, per përmeshjen e programeve dhe problemet e raportuar. Verifikon dhe kontrollon, llogarit vjetore dhe raportet perkatese te ekspertit kontabel te autorizua.
- Keshilli Mbiqyres, ne perputhje me aktet ligjor ne fuqi, miraton shpërblimin e punonjësve shoqerise dhe shqyrtor e miraton propozimet per sponsorizime qe i paraqeten nga drejtoria e shoqerise.

- Keshilli Mbiqyres percakton vleren e kontrates per te cilen drejtoria para se ta lidhe eshte e detyruar te marre autorizimin e keshillit mbiqyres.
- Keshilli Mbiqyres i propozon Ministrir te Ekonomise (Asamblese) lidhur me keto çeshtje:
 - Peraktimin dhe ndryshimin e programit te veprimtarise afatshkurter, afatmesem, afatgjate te shoqerise.
 - Kryerjen e investimeve dhe financimeve per vitin financiar si dhe masat e tjera qe do te kerkonin ndryshimin e kapitalit themelart te shoqerise.
 - Hapjen e veprimtarise ose njeseve te reja dhe ndryshimin e objektit te shoqerise.
 - Shtirjen e pasurive qe perbejne aktivitetin e shoqerise te shoqerise.
 - Krijimin e shoqerive te reja dhe pjesëmarrjen ne kapitalin e shoqerive te tjera.
 - Marrjen e çdo çeshtje tjeter qe ne baze te ligjit per shoqerite tregtare eshte kompetence e asamblese.

Neni 12

Shpërblimi i anetareve te keshillit mbiqyres

- Shpërblimi i anetareve te Keshillit Mbiqyres do te behet ne perputhje me kriteret e përcaktuara ne Vendimin e Keshillit te Ministrave.

Neni 13

Drejtoria, emerimi,

- Shoqeria administrohet nga Drejtoria. Numri i anetareve te Drejtorise caktohet me voten e te pakten 2/3 te gjithë anetareve te keshillit mbiqyres. Me vendimin e te pakten 2/3 te gjithë anetareve te keshillit mbiqyres, njeri prej anetareve emerohet Drejtor i Pergjithshem.
- Ne vendimin e emerimit, percaktohet edhe paga e tyre ne perputhje me aktet ligjor e nen ligjor ne fuqi.
- Anetaret e Drejtorise jane persona fizik, ne te kundert emerimi i tyre eshte i pavlefshem. Kohezgjatja e mandatit te anetareve te Drejtorise eshte 4 vjet. Zëvendësuesi ploteson mandatin e paraardhesit. Ne se nje antar i Keshillit Mbiqyres emerohet anetar i Drejtorise, mandati i tij ne Keshillin Mbiqyres perfundon. Nje person nuk mund te emerohet anetar Drejtor ne me shume se ne nje shoqeri.
- Anetaret e Drejtorise mund te sharkohen nga Keshilli Mbiqyres per shakaqe te perligjura, ose kur asambleja humbet besimin tek ata. Ne rastin kur i interesuari ka detyrimet e kontrates qe lidhur kontrata punesimit me shoqerine, sharkimi i tij nga funksioni i anetarit te Drejtorise nuk eshte shkak per zgjidhjen e kontrates.
- Anetaret e Drejtorise jane te rimerueshem, ata nuk mund te jene mbi moshen 65 vjeç. Anetari i Drejtorise qe mbush moshen 65 vjeç, konsiderohet automatikisht i shkakuar.

Neni 14

Te drejtat dhe detyrat e Drejtorise.

- Drejtoria perfaqeson shoqerine ne marrëdhënie me te tregtet.
- Drejtoria ka te gjitha fuqite ligjore te veprime ne te shoqerise, perveç rasteve qe me ligji i ngarkohen Keshillit Mbiqyres ose asamblese se akcioneve.
- Ne marrëdhënie me te tregtet shoqeria merr persiper detyrimet qe rrjedhin nga vendimet e Drejtorise, te nënshkruara nga anetari me cilesine e Drejtorit te Pergjithshem edhe kur kete i tregtetin objekti i veprimtarise se saj, perveç rastit kur shoqeria provon se te tregtet ishin ne dijeni te faktit qe vendimi i drejtorise tejkaloj objektin e veprimtarise se shoqerise dhe vepron me keqbesim, ose kur te tregtet nuk mund te injorojne kete akt, duke patur parasysh faktin se statute nuk eshte prove e mjaftueshme.
- Vendimet me te cilat shoqeria merr persiper detyrimet ndaj te tregtetve do te nënshkruhen nga anetari me cilesine e drejtorit te pergjithshem ose person i autorizuar nga ky i fundit.
- Drejtoria merr vendim me shumice te thjeshte votash te anetareve te pranishem kur jane prezente jo me pak se gjysma e anetareve te saj. Ne rast barazimi votash, vota e anetarit te caktuar me cilesine e drejtorit te pergjithshem eshte përcaktuese.
- Drejtori i pergjithshem perfaqeson ligjerisht shoqerine. Keshilli mbiqyres gjithashtu mund i jap zv/ drejtorit te pergjithshem, (ne se ka), ose nje anetar tjeter te drejtorise, kompetencen te perfaqesoj shoqerine se bashku apo me vete.

- Drejtori i Pergjithshem organizon, bashkërendon dhe drejton veprimtarine e Drejtorise ne aktivitetin per administrimin e shoqerise.
- Perfaqeson Drejtorine ne marrëdhënie me te tregtet, me gjykatën, me keshillin mbiqyres, asamblese. Nënshkruan kontratat dhe marrëveshjet per te cilat eshte autorizuar drejtoria nga Keshilli Mbiqyres.
- Përgjigjet per aktivitetin e Drejtorise, ne emer te saj raporton ne Keshillin Mbiqyres per çdo tremujor.
- Anetaret e Drejtorise dhe Keshilli Mbiqyres kandidatat per emerimin dhe sharkimin e anetareve te Drejtorise dhe Drejtorat e Qendrave Rajonale.
- Nënshkruan vendimet e Drejtorise ne funksionet te zbatimit te detyrave te caktuara per administrimin e shoqerise.
- Organizon punen per hartimin e projekt-programit ekonomik-financiar te shoqerise dhe pas miratimit nga Ministri i Ekonomise, drejton punen per zbatimin e tij nga te gjithë anetaret e drejtorise dhe strukturat administrative te shoqerise.

- Anetaret e drejtorise jane te gjithë pergjegjës per ushtrimin e funksioneve te caktuara ne drejtorit dhe per zbatimin e vendimeve te keshillit mbiqyres.
- Drejtoria eshte pergjegjese per hartimin e planit ekonomik-financiar te shoqerise, pasqyrimin e gjendjes financiare vjetore dhe raportimin e saj ne keshillin mbiqyres.
- Drejtoria eshte pergjegjese per raportimin ndaj keshillit mbiqyres. Nepermjet drejtorit te pergjithshem, ajo i paraqet keshillit mbiqyres raporte per administrimin shoqerise ne intervale te rregullta, te pakten nje here ne tre muaj. Per teper drejtoria duhet ti raportojte keshillit mbiqyres per çdo rast tjeter te veçante.

- Brenda tre muajve nga mbyllja e vitit financiar te shoqerise, Drejtoria duhet ti paraqes ate shkrim Keshillit Mbiqyres per kontroll dhe verifikim raportit financiar vijtor te Drejtorise, te ekspertit kontabel dhe bilancin e shoqerise.
- Marrëdhëneti brenda shoqerise percaktohet me rregullore e funksionimit te brendshem te shoqerise, ne te cilen percaktohen kriteret e vendimit te punes. Rregullorja miratohet nga Keshilli Mbiqyres.
- Drejtoria per çdo vit i propozon per miratim keshillit mbiqyres strukturën organizative te shoqerise dhe aparatit administrativ te saj.
- Drejtoria emerion dhe sharkon, ne perputhje me dispozitat qe rregullojne marrëdhënet, gjithë punonjësit e shoqerise. Ajo bene marrëveshje kolektive me punonjësit e shoqerise.

Neni 15

Ruajtja e Sekretit

- Anetaret e Keshillit Mbiqyres, te Drejtorise, si dhe punonjësit e tjere te shoqerise, detyrohen te ruajne sekretin edhe pas largimit nga shoqeria per te dhenat qe kane karakter te brendshem te cilat jane peraktuar nga Drejtoria dhe ju jane bere te ditura punonjësve.

Neni 16

Marrëveshjet ndërmjet shoqerise dhe drejtorise ose nje anetari te keshillit mbiqyres.

- Çdo marrëveshje ndërmjet shoqerise dhe anetarit te drejtorise ose nje antari te Keshillit Mbiqyres, qofte e drejtpërdrejte ose jo e drejtpërdrejte duhet ti nënshkruhet autorizimit afatprak te Keshillit Mbiqyres.
- Peraktimi i mesiperem eshte i vlefshem dhe per marrëveshjet ndërmjet shoqerise dhe nje shoqerite tjeter, kur nje antar i Keshillit Mbiqyres eshte edhe anetar i keshillit mbiqyres te nje shoqerite tjeter, me te cilen propozohet te lidhet marrëveshja. Kjo nuk eshte e zabteshume per marrëveshjet qe kane te bejne me veprimtarine rrjedhese te shoqerise qe kryet ne kushte normale.

- Anetari i Drejtorise ose i Keshillit Mbiqyres i interesuar duhet te njoftojte Keshillin Mbiqyres per nje marrëveshje per te cilen zbatohen kërkesat e ketij neni te statutit. Anetari i interesuar i Keshillit Mbiqyres nuk merr pjese ne votimin per dhenien e autorizimit.

Neni 17

Kontrollet

- Kontrollet i brendshem i shoqerise kryhet nga ekspertet kontabel te autorizuar te cilet emerohen nga aksoneri i vetem dhe qe kryen misionin e tij ne pajtim me ligjin Çdo ekspert kontabel do te qendrojte ne detyre per nje vit financiar, vit qe fillon me 1 janar dhe mbaron ne 31 dhjetor te çdo viti. Eksperti kontabel mund te rimerohet. Shpërblimi i tij percaktohet me akte nenligjore.

- Asia e auditimit te brendshem, niveli i se ciles percaktohet nga Keshilli Mbiqyres, sipas njësive te brendshme, miratohet nga Keshilli Mbiqyres, kryen auditin e brendshem ekonomik-financiar dhe te drejtimet te shoqerise dhe raportin para Keshillit çdo tre muaj.

Neni 18

Plani ekonomik

- Drejtoria, ne perputhje me aktet ligjore dhe nenligjore ne fuqi dhe udhezimet e leshuara nga asambleja harton programin e zhvillimit ekonomik-financiar dhe drejtorit e pergjithshem ne emer te Drejtorise i paraqet Keshillit Mbiqyres Pas miratimit, programi degohet ne Asamblene e Aksioneve (M. Ekonomise) per miratim.

Neni 19

Iventari, llogaritë vjetore

- Shoqeria do te mbaje nje kontabilitet te rregullt te pasurise dhe te veprimtarise se saj ne pajtim me kërkesat ligjore. Ne mbylljen e ushtrimit drejtoria harton inventarin e pasurise dhe llogaritë vjetore per ushtrimin financiar. Drejtoria perqatit gjithashtu edhe raportin e administrimit per gjendjen e shoqerise gjate ushtrimit te vitit financiar.

Nene 20 behet:

Rezultati ushtrimor dhe peraktimi i fitimit

- Rezultati i ushtrimit percaktohet si difference ndërmjet te ardhurave dhe shpenzimeve te ushtrimit pasi te jene zbritur humbjet e ushtrimit te meparshem.
- Nga fitimet e ushtrimit, te pakesuara kur eshte rasti me humbjet e meparshe, biqet te pakten 5% (pese perqind) per te kufuar rezerven e domosdoshme.
- Heqja nga fitimet per rezerven e domosdoshme 5% behet e detyrueshme, kur kjo arrij 1/10 (nje te dhjeten) e kapitalit themelart. Ajo rritlon per nje arsye çfaredo, kur rezervat e domosdoshme ka zbritur nen 1/10 (nje te dhjeten) e kapitalit.
- Përdorimi i fitimit pas zbritjes se rezerves ligjore behet me vendim te Asamblese (me urdher te Ministrir te Ekonomise).

Neni 21

Likuidimi dhe mbyllja.

- Shoqeria qubet e mbyllur ne rastet e parashikuara ne ligji Mbledhja e Jashtzakonisht e Asamblese (Ministri i Ekonomise), emerion likuidatorin, per te vepruar sipas kompetencave qe u njeh ligji.
- Me vendim te Asamblese se Jashtzakonisht (Ministri i Ekonomise), shoqeria gjithashtu mund te shpërbehet ose te bashkohet me nje tjeter.

Neni 22

Asambleja e Pergjithshme

- Te gjitha kompetencat e Asamblese se Pergjithshme te parashikuara nga ligji nr. 7638 dt. 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", qe nuk jane shprehur ne kete statut, ushrohen nga Ministri i Ekonomise, me cilesine e aksonierit te vetem.

Neni 23

- Per çfare nuk eshte shprehur ne kete statut, i referohet dispozitave te legjislacionit ne fuqi per shoqerite tregtare.

II. Ndryshime ne aktet e themelimit te shoqerise "Posta Shqiptare" sh.a.

Pika 1 formulohet:

Shoqeria emerohet "Posta Shqiptare" sh.a. Tirane.

Pika 4 formulohet:

Kapitali themelart i shoqerise eshte 697.543.000 leke, i ndare ne 697.542 aksione me vlera nominale 1000 leke.

III. Ngarkohen Drejtoria e shoqerise te kryej ne Gjykate procedurat e depozitimit te ndryshimeve ne aktet e themelimit te shoqerise.

Ky Urdher lhyne ne fuqi menjehere.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
POSTA SHQIPTARE SH.A.
KESHILLI MBIKQYRES

Nr. Prot Date / 2008

V E N D I M

Nr. 37 Dt. 30.6.2008

Mbi

Miratimin e Hapjes "Radio Posta"

Keshilli Mbikqyres i "Posta Shqiptare" SH.A ne mbledhjen e saj te dates 30 / 6 / 2008, pas diskutimit te relacionit te paraqitur te Drejtorise se Shoqerise per nevojen e hapjes se Radio Posta;

V E N D O S I :

1. Te miratoje Hapjen e "Radio Posta".
2. Ngarkohet Drejtoria e Shoqerise Posta Shqiptare sh.a, per pergatitjen e dokumentacionit te nevojshem qe nevojitet per hapjen e "Radio Posta".
3. Ky vendim hyn ne fuqi pas miratimit ne keshillin mbikqyres.

K/Keshillit Mbikqyres
Suzana Panariti



REPUBLIKA E SHQIPERISE
POSTA SHQIPTARE
KESHILLI MBIKQYRES

POSTA SHQIPTARE SH.A
NR. 290 Prot
Date 01.02.08

V E N D I M

Nr. 6 . Date 31.01 . 2008

Mbi

Autorizimin per "Botimin e gazetes periodike te Postes Shqiptare sh.a"

Keshilli Mbikqyres i "Posta Shqiptare" sh.a., ne mbledhjen e tij te dates 31.01.2008, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shoqerise mbi autorizimin per "Botimin e nje gazete nga Posta Shqiptare"

V E N D O S I :

- 1- Te miratoje botimin e gazetes me emrin "Postieri".
- 2- Botimi i gazetes do te jete periodik, nje here ne jave.
- 3-Fondi per botim do te jete 400.000 (katerqindmije) lek ne muaj, dhe keto shpenzime do te mbulohen nga fondi i parashikuar per publicitetin ne media te Postes Shqiptare sh.a
- 4- Ky Vendim hyn ne fuqi menjehere.

K/KESHILLIT MBIKQYRES
Suzana PANARITI



Alca



POSTA SHQIPTARE SH.A
NR. 2135/1 Prot
Date 30.11.2011

REPUBLIKA E SHQIPERISË
Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
Drejtoria e Administrimit të Pronës Publike

Nr 8518/1 Prot.

Tirane, më 30/11 / 2011

Drejtuar: "POSTA SHQIPTARE" SH.A

TIRANË

Lënda: Miratohet statuti i shoqërisë "Posta Shqiptare" sh.a Tiranë

Pasi shqyrtuam projekt statutin e paraqitur për miratim nga shoqëria "Posta Shqiptare" sh.a Tirane dërguar me shkresën tuaj nr. 2135/1, date 22.11.2011 konstatojmë se ai është hartuar në zbatim të dispozitave të nenit 230 të Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Për këto arsye bazuar në nenin 102 pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të Ligjit Nr. 8237, date 01.09.1997 "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 7926, date 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare" ndryshuar me Dekretin Nr. 1195 date 14.08.1995, Ligjin Nr. 8158, date 07.11.1996, ndryshuar me Dekretin Nr. 3318, date 30.04.2002, Ligjin Nr. 8885, date 22.04.2002, nenit 216 e në vijim të Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", aksionari shtet i cili zotëron 100% të aksioneve të shoqërisë "Posta Shqiptare" sh.a Tirane miraton statutin e ri të shoqërisë.

Ngarkohet shoqëria "Posta Shqiptare" sh.a Tirane për kryerjen e veprimeve përkatëse në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" Seksioni III, regjistrimi fillestar, neni 32, 36.

MINISTRI

NASIP NACO



STATUTI I SHOQERISE ANONIME

" POSTA SHQIPTARE"

Bazuar ne Ligjin nr. 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"

KREU I

EMERTIMI I SHOQERISE, SELIA, KOHEZGJATJA

Neni 1

Forma dhe emertimi i shoqerise

1.1 Shoqeria anonime e krijuar ne baze te legjislacionit te Republikes se Shqiperise nga transformimi i Ndermarrjes se Postes Shqiptare emertohet "Posta Shqiptare" SH.A.

1.2 Shoqeria eshte organizuar dhe funksionon ne perputhje me dispozitat e ketij statuti.

1.3 Shoqeria ka stemen dhe vulen e saj e cila miratohet nga Keshilli Mbkqyres i Shoqerise.

Neni 2

Selia e shoqerise

2.1 Selia e shoqerise eshte: Rruga "Reshit Collaku", Nr.4, Tirane.

2.2 Ministria e Ekonomise, Tegetise dhe Energjitikes (Asambleja e Pergjithshme) mund te ndryshoje seline e shoqerise, mund te caktoj ose te mbylle seli dytesore ne Shqiperi dhe jashte saj, mund te hape veprimtari ose njesi te reja brenda dhe jashte vendit si dhe te shtoj apo pakesoje objektin e shoqerise.

Neni 3

Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise do te jete per nje afat te pacaktuar.

KREU II

OBJEKTI

Neni 4

Objekti

4.1 Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte aktiviteti i gjithë shërbimeve postare, financiare dhe bankare; aktiviteti i shërbimeve baze te telekomunikacioneve dhe elektronike; botimi i gazetës "Posteri"; aktiviteti radiofonik "Radio Posta"; veprimtari biznesi; etj. ne perputhje me legjislacionin ne fuqi

4.2 Shoqeria, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, do te kryejë cdo veprimtari tjetër që

1

lidhet drejtpërdrejt ose terthorazi me objektin e parashikuar ne piken 4.1. Kjo perfshin gjithashtu zgjerimin e aktivitetit, krijimin e shoqerive te reja, si dhe pjesemarrjen ne kapitalin e shoqerive te tjera brenda dhe jashte vendit. Pra, Shoqeria mund te marre pjese nepermyet investimeve apo kontributeve kapitale si ortak ose aksionere ne shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, shoqeri aksionare, apo ne forma te tjera te organizimit apo shoqerizimit, te cilat i krijon vete ose tek te cilat merr pjese me ortak/aksionere te tjere vendas apo te huaj.

KREU III

KAPITALI THEMELTAR - AKSIONET

Neni 5

Kapitali themeltar i Shoqerise

5.1 Kapitali i Shoqerise eshte 1.642.447.000 leke qe perbehet nga 1.642.447 aksione me vlerë nominale 1.000 (njemije) leke secili.

5.2 Pronari i vetem i aksioneve eshte shteti Shqiptar i perfaqesuar nga Ministra e Ekonomise, Tegetise dhe Energjitikes.

Neni 6

Ndryshimi i kapitalit dhe transferimi i aksioneve

6.1 Ndryshimi i kapitalit te shoqerise dhe transferimi i aksioneve ne rastin e privatizimit mund te behet vetem me vendim te Asamblese se Jashtezakonshtme te Aksionereve, ne baze te raportit te Drejtorise se Shoqerise te hartuar ne perputhje me dispozitat e ligjit nr. 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

6.2 Persa kohe qe aksioneri i vetem i shoqerise eshte shteti shqiptar i perfaqesuar nga Ministri i Ekonomise, Tegetise dhe Energjitikes, veprimet e mesiperme do te kryhen vetem me Urdher te Tij.

KREU IV

ADMINISTRIMI I SHOQERISE KESHILLI MBKQYRES

Neni 7

Organet drejtuese te shoqerise

Organet drejtuese te shoqerise jane: Keshilli Mbkqyres dhe Administratoret

Neni 8

Perberja dhe emerimi i anetareve te keshillit mbkqyrës

8.1 Keshilli Mbkqyres perbehet nga jo me shume se 7 (shtate) anetare. Anetaret e Keshillit Mbkqyres emerohen nga Ministri i Ekonomise, Tegetise dhe Energjitikes (Asambleja e Pergjithshme) ne perputhje me kriteret e percaktuara ne akte nenligjore.

8.2 Kohezgjatja e funksionit te anetarit te Keshillit Mbkqyres eshte 3 (tre) vjet. Anetaret

2

e Keshillit Mbkqyres jane te rizgjidhshern. Ata mund te shkarkohen ne cdo moment nga Ministri i Ekonomise, Tegetise dhe Energjitikes (Asambleja e Pergjithshme).

8.3 Anetaret e Keshillit Mbkqyres jane individe. Ata nuk mund te jene te punesuar ne shoqeri.

8.4 Anetaret e Keshillit Mbkqyres nuk mund te bejne pjese ne me shume se 2 (dy) Keshilla te shoqerive qe e kane seline ne Republiken e Shqiperise.

8.5 Ne rast vdekje, lirimi nga detyra, apo doreheqje, vendi vakant duhet te zevendesohet jo me vone se 3 (tre) muaj. Anetari i emeruar per te zevendesuar nje anetar te Keshillit Mbkqyres, ploteson kohen e mbetur te mandatit trevjecar te paraardhesit.

8.6 Anetaret e Keshillit Mbkqyres te moshes mbi 65-vjec nuk mund te jene me shume se 1/3 e numerit te pergjithshem te anetareve te Keshillit Mbkqyres. Nese ky raport tejkalohet, anetari me i vjeter eshte i liruar zyrtarisht nga detyra.

Neni 9

Kryetari dhe nenkryetari i Keshillit Mbkqyres

9.1 Keshilli Mbkqyres emerohet midis anetareve te tij Kryetarin dhe Nenkryetarin te cilet kane si detyre thirrjen e mbledhjeve te Keshillit si dhe drejtimin e diskutimeve. Ata emerohen per te gjithë kohezgjatjen e mandatit te tyre dhe mund te rizgjidhen.

9.2 Kryetari dhe Nenkryetari i Keshillit Mbkqyres jane individe. Ata ushtroje funksionet e tyre gjate gjithë periudhes se mandatit trevjecar. Ne rast lirimi, i rizgjedhuri ploteson mandatin e paraardhesit.

9.3 Keshilli Mbkqyres mund te caktoj nje sekretar/re dhe jashte anetareve te tij.

9.4 Ne rast mungese te Kryetarit, mbledhjet e Keshillit do te drejtohen nga Nenkryetari.

Neni 10

Mbledhjet dhe Vendimet e Keshillit Mbkqyres

10.1 Keshilli Mbkqyres mbledhet rregullisht te pakten nje here ne tre muaj si dhe sa here qe e kerkon interesi i shoqerise, me kerkese te Kryetarit, ose ne mungese te tij, nga Nenkryetari.

10.2 Kryetari therrret Keshillin Mbkqyres brenda 15-ditesh nga kerkesa e motivuar e Administratoreve te shoqerise, ose e 1/3 e anetareve te Keshillit Mbkqyres. Nese kerkesa mbetet pa pergjigje, atehere kerkuesit mund te therrasin mbledhjen e Keshillit Mbkqyres duke percaktuar rendin e dites.

10.3 Thirrja behet 3 (tre) dite perpara mbledhjes, me ane te nje letre, telegrami, teleteks apo faksi. Thirrja do te quhet e vlefshme edhe nese komunikohet gojarisht dhe pa respektuar afatin kohor ne rast se anetaret e Keshillit Mbkqyres e pranojne ate.

10.4 Cdo thirrje permban rendin e dites, daten, oren dhe vendin e zhvillimit te mbledhjes. Mbledhjet e Keshillit Mbkqyres zhvillohen zakonisht ne seline e shoqerise

3

ose ne cdo vend tjetër qe do te percaktohet ne njoftimin e mbledhjes.

10.5 Rendi i dites se mbledhjes caktohet nga Kryetari i Keshillit Mbkqyres ne baze te programit vjetor te aktivitetit te tij, te miratuar ne fillim te vitit. Keshilli Mbkqyres mund te shqyrtojë edhe probleme te tjera te rendeshme qe propozohen gjate vitit nga anetaret e Keshillit Mbkqyres ose nga Administratorët.

10.6 Per cdo mbledhje te Keshillit Mbkqyres, ne nje regjister te vecante, mbahet procesverbal i cili neneshkruhet nga Kryetari. Ne te pasqyrohen:
- data dhe vendi i mbledhjes,
- menyra e thirrjes, pjesemarrjesit,
- rendi i dites, drejtesin e mbledhjes,
- permbledhjet te dokumentave dhe raporteve qe do te diskutohen
- permbledhjet te diskutimeve te pjesemarrësve,
- rezultati i votimit dhe vendimet qe merren.

10.7 Vendimet qe merren ne mbledhjen e Keshillit Mbkqyres ne pajtim me dispozitat ligjore ne fuqi te evidentuara sipas proces-verbalit, nenshkruhen nga Kryetari.

10.8 Keshilli Mbkqyres nuk mund te marre vendime te vlefshme pa pranine e te pakten 1/2 e anetareve te tij. Vendimet merren me shumice te thjeshte votash te anetareve te pranishern. Ne rast numer votash te barabarta, vota e Kryetarit mbizoteron.

10.9 Keshilli Mbkqyres mund te organizoj gjithashtu mbledhje dhe te marre vendime te vlefshme me shumice te thjeshte votash nepermyet komunikimeve me shkrim, faks, poste elektronike dhe shërbime postare

10.10 Keshilli Mbkqyres, nese e sheh te arsyeshme, mund te therrase ne mbledhjen e tij Administratorët, ekspertet kontabel te miratuar ose pale te treta per qellime keshillimi.

Neni 11

Kompetencat e Keshillit Mbkqyres

11.1 Keshilli Mbkqyres ushtron kontroll te vazhdueshem ndaj Administratoreve per administrimin e shoqerise nga ana e tyre. Ai u jep ketyre te fundit autorizimin per te kryer operacione qe nuk mund te kryen nga Administratori pa autorizimin e Keshillit Mbkqyres.

11.2 Keshilli Mbkqyres ka te drejte te verifikoj dhe kontrolloje ne cdo kohe dokumentacionin qe e gjkon te nevojshem per përmbyshjen e gjithe detyrave te tij. Ne cilesine e organit mbkqyres, keqyr venien ne zbatim te politikave tregtare dhe perputhjen e tyre me ligjin dhe statutin.

11.3 Keshilli Mbkqyres percakton numrin e administratoreve, emerohet dhe shkarkon ata me shumice te thjeshte votash dhe ndan kompetencat ndermjet tyre. Me miratimin paraprak te Ministrin te Ekonomise, Tegetise dhe Energjitikes (Asamblese se Pergjithshme), Keshilli Mbkqyres emerohet njerin per amnistatoreve me cilesine e Administratori te shoqerise kur jane dakort te pakten 1/2 e te gjithë anetareve te tij.

11.4 Keshilli Mbkqyres apo Asambleja se Pergjithshme mund te shkarkoj ne cdo

4

kohe secilin prej administratoreve me shumice te thjeshte votash.

11.5 Me emerimin e administratoreve, Keshilli Mbkqyres lidh kontrate me ta per detyrimet qe rrjedhin per administrimin e shoqerise.

11.6 Keshilli Mbkqyres percakton nivelin e njesis se auditimit te brendshem ne shoqeri si strukture me vehte. Emelon kryetarin e njesis me shumice te thjeshte votash.

11.7 Miraton programin vjetor te zhvillimit ekonomik-financiar dhe te auditimit te brendshem dhe analizon e kontrollon zbatimin e tyre. Ne cdo tre mujor, ne menyre te permbledhur, informon Ministrine e Ekonomise, Tegetise dhe Energjitikes (Asamblese e Pergjithshme) dhe Ministrine e linjes administrative, ne drejtorite perkatese, per përmbyshjen e programeve dhe problemet e paraqitura. Verifikon dhe kontrollon, llogarit vjetore dhe raportet perkatese te ekspertit kontabel te autorizuar.

11.8 Keshilli Mbkqyres, ne perputhje me aktet ligjor ne fuqi miraton shperblimin e punonjesve te shoqerise dhe shqyrton e miraton propozimet per sponsorizime qe i paraqiten nga Administratori.

11.9 Keshilli Mbkqyres percakton vleren e kontratave per te cilen Administratori perpara sa ta lidhe eshte i detyruar te marre autorizimin e Keshillit Mbkqyres.

11.10 Keshilli Mbkqyres kujdeset qe shoqeria te respektoj ligjin dhe standartet e kontabilitetit, si dhe siguron qe pasqyrat financiare, raportet e ecurise se veprimtarise si dhe detyrimet e tjera te raportimit dhe publikimit, te detyrueshme ne baze te ligjit apo statutit, te kryhen me saktesi nga administratorët.

11.11 Keshilli Mbkqyres i propozon Ministrin te Ekonomise, Tegetise dhe Energjitikes (Asamblese se Pergjithshme) me keto ceshjte:

•Percaktimin dhe ndryshimin e programit te veprimtarise afatshkurter, afatmesem dhe afatgjate te shoqerise.
•Kryerjen e investimeve dhe financimeve per vitin financiar si dhe masat e tjera qe do te kerkonin ndryshimin e kapitalit themeltar te shoqerise.
•Hapjen e veprimtarive ose njesis te reja tregtare brenda apo jashte vendit si dhe ndryshimin e objektit te shoqerise.
•Shitjen e pasurive qe perbejne aktivin e qendrueshem te shoqerise.
•Themelimin e shoqerive tregtare/grupeve te reja dhe/ose pjesemarrjen ne kapitalin e shoqerive te tjera vendase apo te huaja.
•Marrrjen e huave afatmesem dhe afatgjate.
•Si dhe per cdo ceshjte tjetër qe ne baze te Ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" eshte kompetence e Asamblese se Pergjithshme.

Neni 12

Shperblimi i anetareve te keshillit mbkqyrës

12.1 Shperblimi i anetareve te Keshillit Mbkqyres do te behet ne perputhje me kriteret e percaktuara ne Vendimin e Keshillit te Ministrave.

5

KREU V

ADMINISTRIMI I SHOQERISE ADMINISTRATORET

Neni 13

Administratoret, Emërimi

13.1 Shoqeria drejtohet nga Administratori i cili eshte person fizik. Numri i administratoreve caktohet nga Keshilli Mbkqyres. Me shumice te thjeshte votash Keshilli Mbkqyres, emerohet Administratori.

13.2 Ne vendimin e emerimit, percaktohet edhe paga e administratoreve ne perputhje me aktet ligjore dhe nenligjore ne fuqi.

13.3 Administratoret jane persona fizik. ne te kundert emerimi i tyre eshte i pavlefshern. Kohezgjatja e mandatit te Administratoreve eshte 3 vjet. Zevendesuesi ploteson mandatin e paraardhesit. Nese nje anetar i Keshillit Mbkqyres emerohet administrator, mandati i tij ne Keshillin Mbkqyres perfundon. Nje person nuk mund te jete administrator ne me shume se ne nje shoqeri.

13.4 Administratoret e shoqerise nuk i mund te zgjidhen si administratore apo kryetar te keshillit te administrimit te shoqerive te kontrolluara (bija) dhe anasjelltas. Cdo emerim i bere ne kundërshtim me kete dispozite eshte absolutisht i pavlefshem.

13.5 Administratoret mund te shkarkohen ne cdo kohe nga Keshilli Mbkqyres apo Asambleja e Pergjithshme. Ne rastin kur ndonje prej administratoreve ka maredhenie kontraktore me shoqerine, padite lidhur me shperblimin e tij rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

13.6 Administratoret jane te rimerueshem. ata nuk mund te jene mbi moshen 65 vjec. Administratori qe mbush moshen 65 vjec, konsiderohet automatikisht i shkarkuar.

Neni 14

Te drejtat dhe detyrat e Administratoreve

14.1 Administratoret perfaqesojne shoqerine ne maredhenie me te tretet.

14.2 Administratoret kane te gjitha fuqite ligjore te veprjone ne emer te shoqerise, pervec rasteve kur me ligji i ngarkohen Keshillit Mbkqyres.

14.3 Aktet me te cilat shoqeria merr persiper detyrimet ndaj te treteve duhet te nenshkruhen nga Administratori ose personi i autorizuar rregullisht nga ky i fundit per kete akt.

14.5 Administratoret marrin vendim me shumice te thjeshte votash te anetareve te pranishern kur jane prezente jo me pak se gjysma e anetareve te saj. Ne rast barazimi votash, vota e anetarit te caktuar me cilesine e Administratorit eshte percaktuese.

14.6. Administratori perfaqeson ligjerisht shoqerine.

6

14.7 Administratori organizon, bashkerendon dhe drejton aktivitetin per administrimin e shoqerise:
• Nenshkruan kontrata dhe marreveshje per te cilat eshte autorizuar nga Keshilli Mbkqyres.
• Pergjigjet per aktivitetin e shoqerise dhe raportin ne Keshillin Mbkqyres per cdo tremujor. I propozon Keshillit Mbkqyres kandidatet per emerimin dhe shkarkimin e Drejtorave te Qendrave Rajonale.
• Nenshkruan vendimet ne funksion te zbatimit te detyre te caktuara per administrimin e shoqerise.
• Organizon punen per hartimin e projekt-programit ekonomik-financiar te shoqerise dhe pas miratimit nga Ministri i Ekonomise, Tegetise dhe Energjitikes (Asambleja e Pergjithshme) drejton punen per zbatimin e tij nga strukturat administrative te shoqerise.

14.8 Administratoret jane pergjegjes per ushtimin e funksioneve te caktuara dhe per zbatimin e vendimeve te Keshillit Mbkqyres. Ata i paraqesin Keshillit Mbkqyres raporte per administrimin e shoqerise ne intervale te rregullta, te pakten nje here ne tre muaj. Per me teper, i raportojne Keshillit Mbkqyres per cdo rast tjetër te vecante

14.9 Administratoret jane pergjegjes per ushtimin e funksioneve te caktuara dhe per shoqerise, pasqyrimin e gjendjes financiare vjetore dhe raportimin e saj ne Keshillin Mbkqyres. Brenda tre muajve nga mbyllja e vitit financiar te shoqerise, i paraqesin me shkrim Keshillit Mbkqyres per kontroll dhe verifikim raportin financiar vjetor te shoqerise te ekspertit kontabel dhe bilancin e shoqerise.

14.10. Maredheniet brenda shoqerise, funksionet dhe kriteret e vendeve te punes, percaktohen me rregulloren e funksionimit te brendshem te shoqerise, e cila miratohet nga Keshilli Mbkqyres.

14. 11 Administratoret cdo vit i propozojne per miratim Keshillit Mbkqyres strukturen organizative te shoqerise dhe aparatit administrativ te saj.

14.12 Administratorët emerojne dhe shkarkojne punonjesit e shoqerise ne perputhje me dispozitat qe rregullojne maredheniet e punes.

14.13 Administratoret vendosin krijimin e bashkepunimeve tregtare afatgjata si dhe propozojne politikat per themelimin e shoqerive tregtare ose te grupeve te reja.

Neni 15

Ruajtja e Sekretit

Anetaret e Keshillit Mbkqyres, Administratorët, si dhe punonjesit e tjere te shoqerise, detyrohen te ruajne sekretin edhe pas largimit nga shoqeria per te dhenat qe kane karakter te brendshem te cilat jane percaktuar e miratuar nga Administratorët dhe ju jane bere te ditura punonjesve.

7

Neni 16

Marreveshjet ndermjet Shoqerise dhe Administratoreve ose nje anetari te Keshillit Mbkqyres.

16.1 Cdo marreveshje ndermjet Shoqerise dhe Administratoreve ose nje anetari te Keshillit Mbkqyres, qofte e drejtpërdrejte ose jo e drejtpërdrejte duhet te nenshtrohet autorizimit paraprak te Keshillit Mbkqyres.

16.2 Percaktimi i mesiperme eshte i vlefshem edhe per marreveshjet ndermjet shoqerise dhe nje shoqerie tjetër, kur nje anetar i Keshillit Mbkqyres eshte edhe anetar i Keshillit Mbkqyres te nje shoqerie tjetër, me te cilen propozohet te lidhet marreveshja. Kjo nuk eshte e zbatueshme per marreveshjet qe kane te bejne me veprimtarite rredhese te shoqerise qe kryhen ne kushte normale.

16.3 Administratoret ose nje anetar i Keshillit Mbkqyres i interesuar duhet te njoftoj Keshillin Mbkqyres per nje marreveshje per te cilen zbatohen kerkesat e ketij neni te statutit. Anetari i interesuar i Keshillit Mbkqyres nuk merr pjese ne votimin per dhenien e Autorizimit.

KREU VI

KONTROLLI, USHTRIMI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, FITIMET

Neni 17

Ekspertet kontabel te autorizuar

Kontrolli i shoqerise ushtrohet nga ekspertet kontabel te autorizuar te cilet emerohen per nje ushttrim financiar nga aksioneri i vetem (Asambleja e Pergjithshme). Shperblimi i tij percaktohet me akte nenligjore.

Neni 18

Kontrolli

Njesia e auditimit te brendshem, niveli i se ciles percaktohet nga Keshilli Mbkqyres, sipas nje programi vjetor te miratuar nga Keshilli Mbkqyres. kryen auditimin e brendshem ekonomik-financiar dhe te drejtimin te shoqerise dhe raportin para Keshillit Mbkqyres cdo tre muaj.

Neni 19

Plani ekonomik

Administratoret, ne perputhje me aktet ligjore dhe nenligjore ne fuqi dhe udhezimet e leshuara nga Asambleja e Pergjithshme hartojne programin e zhvillimit ekonomik-financiar dhe e paraqesin per miratim nga Keshilli Mbkqyres. Pas miratimit, programi dergohet ne Asamblese e Pergjithshme (Ministrine e Ekonomise, Tegetise dhe Energjitikes).

Neni 20

Ushtrimi financiar, inventari, llogarite vjetore

20.1 Ushtrimi financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron ne 31 Dhjetor te cdo viti.

8

20.2 Administratoret do te mbajne nje kontabilitet te rregullt te pasurise dhe te veprimtarise se Shoqerise ne pajtim me kerkesat ligjore. Ne mbyllje te ushtimit vjetor per ushtimin financiar, Administratoret hartojne inventarin e pasurise ne kete date dhe llogarit administrimit per gjendjen e shoqerise gjate ushtimit financiar.

Neni 21

Rezultati i vitit ushtimor dhe percaktimi i fitimit

21.1 Administratoret hartojne bilancin e ushtimit vjetor ne pajtim me kerkesat ligjore, 5 % e fitimeve qe rezultojne nga bilanci i vitit ushtimor i miratuar sipas parashikimeve te Ligjit hiqet per te krijuar rezerven e domosdoshme.

21.2 Heqja nga fitimet per rezerven e domosdoshme nuk eshte e detyrueshme, kur kjo arrin 1/10 e kapitalit themeltar te shoqerise.

21.3 Fitimi i mbetur shperndahet me vendim te Asamblese se Pergjithshme (Ministrise se Ekonomise, Tegetise dhe Energjitikes).

Neni 22

Likuidimi dhe prishja.

22.1 Shoqeria konsiderohet e prishur me realizimin e ngjarjeve te parashikuara ne ligji. Ne rast prishjeje Asambleja e Jashtezakonshtme (Ministri i Ekonomise, Tegetise dhe Energjitikes), cakton nje ose me shume likuidatore, duke ju dhene atyre kompetencat perkatese.

22.2. Me vendim te Asamblese se Jashtezakonshtme (Ministri i Ekonomise, Tegetise dhe Energjitikes), shoqeria gjithashtu mund te prishet ose te bashkohet me nje tjetër.

16.1.

Neni 23

Asambleja e Pergjithshme


Te gjitha kompetencat e Asamblese se Pergjithshme te parashikuara nga ligji nr. 9901 dt. 14.04.2008. "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", qe nuk jane shprehur ne kete statut, ushtrohen nga Ministri i Ekonomise, Tegetise dhe Energjitikes me cilesine e aksionerit te vetem.

Neni 24

Per cfare nuk eshte shprehur ne kete statut, behet referimi ne dispozitat e legjislacionit ne fuqi per shoqerite tregtare.

MINISTRI

NASIP NACO



Tirane, me 30/11/2011



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS PUBLIKE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHETËTËRORE

15675/3
Nr. _____ prot.

2266/4
8.10.19
Tiranë, më 27.9.2019

VENDIM I ASAMBLESË SË AKSIONARIT

Nr. 92, datë 27.9.2019

PËR

MIRATIMIN E VENDIMIT NR. 25, DATË 2.8.2019 TË KËSHILLIT
MBIKËQYRËS TË SHOQËRISË “POSTA SHQIPTARE” SHA
TIRANË “MBI USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË “POSTA
SHQIPTARE” SHA, SI AGJENT NË TREGUN E SIGURIMEVE”

Në mbështetje të Ligjit Nr.7926, datë 20.04.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, Vendimit Nr. 570, datë 3.10.2018 të Këshillit të Ministrave “Për Këshillat Mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore” dhe Statutit të shoqërisë, me cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të shoqërisë “Posta Shqiptare” sha Tiranë, pasi shqyrtova vendimin e marrë nga Këshilli Mbikëqyrës;

VENDOSA

1. Miratimin e Vendimit Nr. 25, datë 2.8.2019 të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë “Posta Shqiptare” sha Tiranë, “Mbi ushtrimin e veprimtarisë së “Posta Shqiptare” si agjent në tregun e sigurimeve”.
2. Ngarkohet Administratori i shoqërisë “Posta Shqiptare” sha Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



Anjeza koka
AH

SEKRETARIA



521
6 3 20

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS PUBLIKE
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHTETËRORE

Nr. 4176/prot.

Tiranë, më 5.3.2020

VENDIM I ASAMBLESË SË AKSIONARIT

Nr. 26, datë 5.3.2020

PËR MIRATIMIN E PJESËMARRJES SË POSTËS SHQIPTARE SHA, NË VEPRIMTARINË SI INSTITUCION I PARASË ELEKTRONIKE.

Në mbështetje të Ligjit Nr.7926, datë 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", të ndryshuar, Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, Statutit të shoqërisë "Posta Shqiptare" sha Tiranë, shkresës Nr. 8287/1, datë 4.10.2019 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, dhe Vendimit Nr. 24, datë 2.8.2019 "Mbi miratimin në parim të pjesëmarrjes së Postës Shqiptare sha, në veprimtarinë si institucion i parasë elektronike, me cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të shoqërisë "Posta Shqiptare" sha Tiranë ;

VENDOSA

1. Miratimin e pjesëmarrjes së shoqërisë "Posta Shqiptare" sha Tiranë, në veprimtarinë si institucion i parasë elektronike.
2. Ngarkohet Administratori i shoqërisë "Posta Shqiptare" sha Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR
Anila Denaj

